URDHËR
Nr. 79, datë 9.5.2022

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 3, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, znj. Enkela Dudushi, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike.
2. Delegimi i kompetencave fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe mbaron me shfuqizimin tij.
3. Ngarkohet znj. Enkela Dudushi, drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike, në Departamentin e Administratës Publike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama